



Projekti mbështetet financiarisht
nga Bashkimi European



PROJEKTI: KODI I GJELBËR “TURIZMI I STANDARTEVE TË GJELBËR”

Turizmi prej dekadash është konsideruar si një përpjekje kritike nga ambientalistët, për të vlerësuar e shijuar destinacionet natyrore, pa cënuar biodiversitetin.

Kjo formë turizmi, që përfshin vizita në zona natyrore të ndjeshme dhe të paprekura, si destinacion i turizmit masiv, është në rritje të ndjeshme në vendin tonë.

Udhëtimet turistike dhe edukative kanë në fokus destinacione në qytetin e Beratit, ku flora, fauna dhe trashëgimia kulturore janë atraksionet kryesore. Synimet kryesore janë:

- Rritja e ndjeshmërisë sociale dhe përgjegjshmërisë për mjedisin dhe habitatet natyrore;
- Ruajtja e mjedisit natyror;
- Mbrojtja ekologjike e specieve të rrezikuara;
- Rritja e mirëqënies së rezidentëve e zhvillimi ekonomik, duke respektuar kulturën e traditat vendase;
- Fuqizimi strategjik për mirëmenaxhimin e komuniteteve lokale;

PROJEKTI GEAR NË QYTETIN E BERATIT

Në muajin Shtator organizata “Për Mirëqënie Sociale dhe Mjedisore” Berat, ka filluar zbatimin e projektit “KODI I GJELBER”- Turizmi i standarteve të gjelbër, me kontribut financiar të Bashkimit European, i financuar në kuadër të projektit GEAR - Ekonomia e Gjelbër për një Zhvillim Rajonal. Projekti zbatohet në Berat, për 12 muaj me një fond prej 5000 Eurosh.

Në këtë kuadër, organizata zbatuese e projektit: “Për Mirëqënie Sociale dhe Mjedisore”, merr përsipër të nxisë standarte të gjelbra në sektorin e turizmit dhe t’i implementojë në tre lagjet muzeale të Beratit.

Në këtë Projekt Pilot do të promovohen elementë të “ekonomisë së gjelbër”, teknika të reja pranë operatorëve turistikë, për të ofruar një kulturë të re të menaxhimit të mbetjeve, sensibilizuar popullatën për vlerat e riciklimit dhe efijencës së energjisë.

Ky projekt do të përmbushet nëpërmjet ngritjes së rrjetit “Kodi i Gjelbër”, me shtrirje në këto tre lagje. Ky rrjet do të ketë target grupin e tij, vullnetarë të operatorëve turistik, guidave turistike, insitucion arsimor dhe local, të cilët do të konkretizojnë planin dhe aktivitetet në kuadër të #Ekonomisë së gjelbër.

Aktivitetet konkrete në kuadër të Projektit GEAR:

1. Riciklimi i mbetjeve që në burim (ndërgjegjësim);
2. Kompostimi i mbetjeve organike dhe shndërrimi në pleh organik i mbetjeve të gjelbra, duke minimizuar mbetjet;
3. Ulja e sasisë së gazeve të dëmshme në atmosferë, duke përdorur plehun organik, e gjelbëruar ambjentin;
4. Ripërdorimi i mbetjeve tekstile duke i kthyer ato në objekte të përdorshme (çanta, varëse rrobash etj.);

Ndërgjegjësimi për përdorimin e energjisë së pastër (llamba e pajisje elektrike eficiente, përdorimi e energjisë diellore etj.).

"Ky dokument është prodhuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Europian. Përmbajtja e këtij dokumenti është përgjegjësi e organizatës : " Për Mirëqenie Sociale dhe Mjedisore" Berat dhe nuk mund të konsiderohet asnjëherë si pasqyrim i pozitës së Bashkimit Evropian dhe Qendrës EDEN

